



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Përftimi i kontrollit nga INA INDUSTRIJA NAFTE d.d. dhe PRVO PLINARSKO DRUSTVO d.o.o mbi PETROKEMIJA d.d

Përfaqësuesi ligjor Kalo & Associates ka informuar Autoritetin e Konkurrencës me shkresën Nr. 401 Prot., datë 25.06.2018, protokoll i AK, “INA/PPD/PETROKEMIJA-Përqendrim-Njoftim sipas Ligjit Shqiptar për Mbrojtjen e Konkurrencës”, në cilësinë e përfaqësuesit të INA-Industrije Naftë d.d dhe Prvo plinarsko drustvo d.o.o lidhur me krijimin e një ndërmarrjeje të përbashkët e zotëruar në masën 50% nga secila prej tyre. Ndërmarrja e përbashkët do të synojë marrjen e kontrollit mbi shoqërinë PETROKEMIJA.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

Blerësi 1: INA-Industrije Naftë d.d¹ është një shoqëri e themeluar në Republikën Kroate. INA është pjesë e grupit MOL Hungarian Oil dhe Gas Plc.

Mol është aktive në mbarë botën në eksplorimin dhe prodhimin e naftës bruto, gazit natyror dhe produkte të tjera të gazit, rafinim, transportim dhe magazinim i naftës bruto dhe shitje me shumicë dhe tregtim me pakicë të produkteve të naftës bruto etj.

INA dhe MOL janë prezentë në Shqipëri nëpërmjet shoqërive të grupit CROSCO dhe Slovnaft.

Blerësi 2: Prvo plinarsko drustvo d.o.o (PPD)² është një shoqëri e themeluar në Republikën Kroate. PPD kryen aktivitet në fushat e importit, shitjes, furnizimit dhe shpërndarjes së gazit natyror. PPD ka selinë ligjore në Kroaci dhe filiale në Zvicër, Hungari, Bosnjë-Hercegovinë dhe në serbi, nëpërmjet të cilave kryen veprimtarinë-duke filluar nga shpërndarja dhe furnizimi i gazit natyror, burimet e energjisë së rinovueshme, tregtia e produkteve të naftës, teknologjinë e informacionit dhe inovacionit për projektet e investimit dhe transportit.

Shoqëria target: PETROKEMIJA d.d³ është një shoqëri e themeluar në Republikën Kroate. Petrokemija prodhon fertilizues mineralë⁴ duke përdorur lëndë të parë natyrale

¹ Burimi: Ekstrakti nga Regjistri Gjyqësor. Numri identifikues i shoqërisë 080000604, Numri Identifikues Personal 27759560625, shoqëri aksionere, me kapital themeltar 9000000000,00 kuna

² Burimi: Ekstrakti nga Regjistri Gjyqësor dhe Akti I Themelimit të shoqërisë. Kapitali I shoqërisë është 20.959.800,00 Kuna. Numri identifikues personal 58292277611, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

³ Burimi: Ekstrakti nga regjistri Gjyqësor. Numri identifikues personal 24503685008, shoqëri aksionere, kapitali 42.903.930,00 kuna.

⁴ Burimi: Statuti I Petrokemija d.d: Neni 3 përcakton se emri i kompanisë është Petrokemija d.d, fabrikë plehrash.

minerale, gaz natror, nitrogjen dhe oksigjen atmosferik. Ajo prodhon dhe shet këto fertilizues minerarë në pjesën më të madhe në Kroaci. Ajo ofron gjithashtu bentorinte dhe shtues për fonderi, aditivë ushqimorë për bagëti, pleh, gjithashtu edhe fertina, i cili është një produkt fertilizues i lëngshëm.

Ndërmarrja JV: Terra Mineralna Gnojiva d.o.o, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, shoqëri për këshillim dhe administrim. Shoqëria e ka selinë në Zagreb dhe themelohet për një kohë të caktuar. Objekti i kësaj shoqërie është blerja dhe shitja e mallit, përfaqësimi i firmave të huaja, kryerja e ndërmjetësimit në tregun vendas dhe të huaj, këshillim në lidhje me biznesin dhe administrimin, etj.

Në datë 25.05.2018 Ina dhe PPD kanë paraqitur një ofertë konfidenciale për shprehje interesi për aksionet e Petrokemija, drejtuar qeverisë Kroate.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.